



01/Nr.2777/2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2021 merr:

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2021**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për periudhën Janar - Mars 2021.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për periudhën Janar-Mars 2021 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2021 është në shumë prej 2,550,742.73 €, në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 415,354.61 € apo 25.70 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 49,117.22 € apo 14.19 %, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 9,057.98 € apo 13.52 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 4,900.00 € apo 6.53%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 33,752.67 € apo 8.62 % dhe në rezervat 0.00 €. Totali i shpenzimit për periudhën Janar -Mars të vitit 2020 është në shumë prej 512,182.48 € apo 20.08 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 54,068.48 € të hyra vetanake për periudhën janar-mars 2021 apo 18.73% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje më shumë për 4,960.24 € apo 10.10%.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 29.04.2020





01/Nr. 9228 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26 neni 11 paragrafi 11.2, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore neni 6, pika 6.3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2021 merr:

**V E N D I M**  
**PËR NDËRRIM DESTINIM TË TOKËS BUJQËSORE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore për pronarin z.Sokol Loku sipas kërkesës së tij.
2. Sipërfaqja e lejuar bujqësore për ndërrim të destinimit është 132 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Oborrë" zona kadastrale Paldenicë, më kulturë kullosë e klasit të gjashtë (6), e evidentuar në emër të z. Sokol Loku, sipas certifikatës pronësore P-73317066-01134-6.
3. Parcela e lartë shënuar gjendet në planin zhvillimor komunal dhe është në zonën ndërtimore, andaj u vendos që destinimi i pronës më kulturë kullosë e klasit të gjashtë (6) të bëhet parcelë ndërtimore sipas parashtruesit të kërkesës.
4. Pronari i palujtshmërisë në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që pronën ta shfrytëzoj vetëm për qëllimin e caktuar (ndërtim për banim) e nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Parashtruesi i Kërkesës,
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Kadastër,
- Drejtoria për Bujqësi,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 29.04.2021



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**





Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 3230 /2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, neni 9, paragrafi 9.1, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 29.04.2021 merr:

**VENDIM**

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01.NR.2010/2021 PËR TRANSFER TË MJETEVE  
NGA KATEGORIA EKONOMIKE REZERVA NË SHPENZIME KAPITALE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
2. Transferi i mjeteve nga kategoria rezerva në shpenzime kapitale është në shumë prej 55,000.00 € për vitin 2021, në shumë prej 160,000.00 € për vitin 2022, si dhe në shumë prej 270,375.00 € për vitin 2023 nga fondet 10, 21, sipas nën-programeve buxhetore dhe projekteve kapitale.
3. Të transferohen mjetet nga kategoria Rezerva e nën-programit Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) në kategorinë shpenzime kapitale në nën-programin Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480), nga fondi 10 dhe 21 në projektet si vijon:

Kodi i proj.	Emërtimi i projektit	Fondi Burimor	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
I ri	Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave në zonat rurale të Hanit të Elezit në fshatin Paldenicë (Rr. Gafurr Loku, Rr. Driton Loku, Rr. Udha e Shkronjave, Rr. Rezistenca, Rr. Imer Vila, Rr. Dituria, Rr. Kushtrimi i Lirisë), në fshatin Seçishtë (Rr. Brigada 164, Rr.UÇK, Rr. Dëshmorët e Krivenikut, Rr. 28 Nëntori), në fshatin Pustenic (Rr. Epopeja e UÇK, Rr. Suad Brava, Rr. Izet Bushi ), në fshatin Gorancë (Rr. Liria)	GQ-10	30,000.00	50,000.00	80,000.00
I ri	Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në zonën urbane (Rr. Isa Berisha) dhe zonat rurale në fshatin Paldenicë (Rr. Udha e Shkronajve, Rr. Dheu i Bardhe), në fshatin Dermjak (Rr. Nehat Curri), në fshatin Pustenic (Rr. Epopeja e UÇK), në fshatin Seçishtë (Rr. Veteranët e UÇK), në fshatin Gorancë (Rr. Liria, Rr. Sharri), në fshatin Krivenik (Rr. Dëshmorët e Krivenikut)	GQ-10	20,000.00	50,000.00	120,000.00

I ri	Rregullimi i shtigjeve për këmbësor dhe çiklistë përgjat lumit Lepenc (Uji i thartë - Kulla me çeshme).	THV-21	0	50,000.00	60,375.00
Totali			50,000.00	150,000.00	260,375.00

**Të transferohen mjetet nga Rezerva e nën-programit:**

Administrata e arsimit (92175), shuma prej 5,000.00 € për vitin 2021,  
 Administrata e arsimit (92175), shuma prej 10,000.00 € për vitin 2022,  
 Administrata e arsimit (92175), shuma prej 10,000.00 € për vitin 2023.

**Në kategorinë shpenzime kapitale në nën-programin Administrata e arsimit (92175), nga fondi burimor 10 dhe 21, në projektin si vijon:**

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Fondi Burimor	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
I ri	Riparimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Pustenik	GQ-10	0	10,000.00	10,000.00
		THV-21	5,000.00	0	0
Totali			5,000.00	10,000.00	10,000.00

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

5. Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
 Data: 29.04.2021

